



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 781/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret Adnan Konushevci kryesues, Afijete Sada- Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativës Qytetare Sloboda Shtërpca, dega në Shtërpçë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë

V E N D I M

HUDHET i pasafatshëm apeli A.nr.781/2021 e datës 04.11.2021, i paraqitur nga Iniciativës Qytetare Sloboda Shtërpca, dega në Shtërpçë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 04.11.2021, ka pranuar një ankesë nga Iniciativa Qytetare Sloboda Shtërpca, dega në Shtërpçë, me të cilën pretendon se me datë 17.10.2021 në ditën e zgjedhjeve lokale kanë vërejtur një numër të madh të parregullsive në Komunën e Shtërpçës, veçanërisht në qendrat zgjedhore në Jazhincë në vendvotimet 2306D/01R dhe 2306D/02D, në Komunën e Shtërpçë vendvotimet 2303D/01R, 2303D/02, 2303R/03R dhe 2303D/04D si dhe në fshatin Gotovush në vendvotimin 23080/010. Lidhur me këto parregullsi të cilat janë raportuar nga vëzhguesit thekson se nuk ka reaguar askush nga organet kompetente të rendit, as policia dhe as stafi para KQZ-së ashtu që në kohën e numërimit të votave pas mbylljes së vendvotimit është regjistruar anulim i qëllimshëm i fletëvotimeve veçanërisht për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Shtërpçë me qëllim që qartë për të dëmtuar votat e dedikuara për IQ Sloboda Shtërpçë me qëllim të uljes së numrit të këshilltarëve. Sipas parashtruesit të ankesës një numër i madh i fletëvotimeve që u shënjuan për G.I.I.S gjatë numërimit iu shtuan edhe një parti për ta bërë fletën e pavlefshme e këto paraqitën parregullsi

të cilat sipas tyre deshën ti raportonin mirëpo në linjat që kishin thirrur nuk iu ishte përgjigje askush në më shumë se 10 tentativa. Prandaj me anë të ankesës së paraqitur ka kërkuar që të përsëritet votimi apo të rinumërohen dhe të rishikohen fletëvotimet që janë dëmtuar qëllimisht për tu shpallur të pavlefshme.

Paneli, pas shqyrtimit të afatshmërisë së apelit, në këtë fazë të procesit zgjedhor, gjeti se,

Apeli është i pasafatshëm, për këto arsye:

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar apeli në PZAP, me pretendime nga ankuesi se ka pasur parregullsi gjatë ditës së votimit nuk mund të procedohet si ankesë e afatshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”,* nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, për kandidatë të Kuvendit Komunal me datë 03.11.2021, mund të parashtrohen apele në PZAP, vetëm për rezultatet e shpallura nga KQZ-ja. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e me asnjë Rregull Zgjedhore, nuk parashihet mundësia që të konsiderohet e afatshme një apel, që ka të bëjë me parregullsitë gjatë ditës së votimit.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.781/2021 më datë 05.11.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Kofushevc



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.